VENDIM
Nr.75, datë 2.2.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "BY PASS PLEPA – KAVAJË – RROGOZHINË, LOTET 6 E 7"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2010 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "By pass Plepa Kavajë – Rrogozhinë, lotet 6 e 7".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 2810 m^2, truall dhe arë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 25 598 413 (njëzet e pesë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 592 000 (pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 25 598 413 (njëzet e pesë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekësh të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve ".

6. Shpronësimi të fillojë më 1.2.2011 dhe të përfundojë më 1.5.2011.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

9. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Proces regjistrimi", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të përfundojë procedura e regjistrimit dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja, Kavajë", pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi "Proces regjistrimi", pasi pronarët të kenë përfunduar procedurat e regjistrimit, si dhe pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë.

12. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kavajë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të vendimit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

13. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kavajë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

14. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e

Përgjithshme e Rrugëve dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha